



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 664/26

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje prej: Isa Hasani-kryetar, Batisha Ibrahim – dhe Kimete Gashi- anëtare, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Policia e Kosovës, me numër 664/26, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE "Ida Auto Group"Sh.p.k dhe OE "Leicon"Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Shërbimet për pastrimin e automjeteve policore për regjionin e Prishtinës (kampi vrella), Prizrenit dhe Gjilanit, me nr: te prokurimit: 214-26-1596-2-2-1, iniciuar nga Policia e Kosovës, më: 09.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET, si e pa bazuar në dispozitën ligjore të nenit 99 par. 2 të LPP-së, kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Policia e Kosovës dt.27.04.2026, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE "Ida Auto Group"Sh.p.k, me nr: unik: 812247296 – Prishtinë dhe OE "Leicon"Sh.p.k, me nr: unik: 812053958 - Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Shërbimet për pastrimin e automjeteve policore për regjionin e Prishtinës (kampi vrella), Prizrenit dhe Gjilanit", me nr: te prokurimit: 214-26-1596-2-2-1, iniciuar nga Policia e Kosovës.

ARSYETIM

Kërkesa e AK – Policisë së Kosovës:

1. Autoriteti kontraktues pretendon se operatorëve ekonomik Ida Auto Group dhe Leicon, si pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me titull: Shërbimet për pastrimin e automjeteve policore për regjionin e Prishtinës (kampi vrella), Prizrenit dhe Gjilanit, me nr: te prokurimit: 214-26-1596-2-2-1, kanë vepruar në kundërshtim me nenin 5 – marrëveshjet e ndaluara (kartelet) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 08/L-056.
2. Në vazhdim AK - Policia e Kosovës, ka sqaruar se ky aktivitet i prokurimit është ndare në Pjese/Lote:
Grupi 1. - REGJIONIN E PRISHTINËS.
Grupi 2. - REGJIONIN E PRIZRENIT.
Grupi 3. - REGJIONIN E GJILANIT.
3. Me tutje autoriteti kontraktues ka sqaruar se OE-te e lartpërmendur i kanë dorëzuar ofertat në pjesë të ndryshme, konkretisht OE” Ida Auto Grup” ka ofertuar në pjesën 3 të projektit – Regjionin e Gjilanit, ndërsa OE “Leicon” ka ofertuar për pjesën 1 dhe 2 - Regjionin e Prishtinës dhe të Prizrenit.
4. Gjatë vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktues deklaron se, kemi vërejtur se polica e sigurimit me nr: 149293 e lëshuar në emër të OE Ida Auto Group është gjendur në ofertën e OE Leicon dhe po ashtu e njëjta police e sigurimit gjendet edhe në ofertën e OE Ida Auto Group, pra e njëjta police gjendet në të dy ofertat, pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit por që kanë ofertuar për pjesë të ndryshme, sic është sqaruar edhe më lartë.
5. Autoriteti kontraktues, pretendimin e saj se dy operatorët ekonomik kanë vepruar në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 08/L-056, e bazon edhe në faktin se pronarët e dy operatorëve ekonomik, e kanë të njëjtin mbiemër dhe njëherit deklaron se të dy operatorët ekonomik ka dhënë çmim të njëjtë për pjesën 2 dhe pjesën 3.

Mbi bazën e sqarimeve të dhëna më lartë, autoriteti kontraktues kërkon marrjen e masave eventuale sipas nenit 99.2 të LPP-se me pretendimin se OE-te Ida Auto Group dhe OE Leicon kanë vepruar në kundërshtim me nenin 5 – marrëveshjet e ndaluara (kartelet) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 08/L-056, ku sipas pikës 1 të këtij neni ndalohen të gjitha marrëveshjet që kanë për qëllim parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në tregun përkatës dhe se sipas pikës 1.1 të këtij neni janë të ndaluara marrëveshjet që drejtpërdrejtë ose tërthorazi caktojnë çmimet, kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet etj.

Kërkesa e OSHP-së drejtuar Operatorëve Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me te pranuar kërkesën e datës: 28.04.2026, te AK - Policia e Kosovës, i ka njoftuar OE-te Ida Auto Group dhe OE Leicon, me qellim qe operatoret ekonomik ne fjale te jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

- OE Ida Auto Group, në përgjigje te kërkesës se OSHP-se, ka dhëne faktet dhe argumentet e veta lidhur me pretendimet e AK-se, duke propozuar qe kërkesa e AK- Policia e Kosovës, te refuzohet si e pa bazuar.

Ne vazhdim te sqarimit te tij, OE Ida Auto Group, ka sqaruar se ne lidhje me ketë fakt kemi kontaktuar me kompaninë e sigurimit, ku na është sqaruar se ka ndodhur një gabim teknik fillimisht nga kompania e sigurimeve e cila gabimisht e ka dorëzuar tek kompania jone dhe pastaj edhe te OE Leicon, ku këta te fundit nuk e kanë analizuar policen e pranuar dhe e kanë bashkangjitur ne oferte.

Sa i përket tendencës se autoritetit kontraktues, per ta paraqitur si marrëveshje e fshehtë, sipas OE Ida Auto Group, është e pa argumentuar me vet faktin se kemi ofertuar ne pjese te ndryshme, pra sipas OE Ida Auto Group kemi ofertuar vetëm ne pjesën apo Lot 3 - Regjionin e Gjilanit.

Prandaj, sipas OE Ida Auto Group te pretendohet se është marrëveshje e fshehtë kur dy OE ofertojnë ne Lote te ndryshme është e palogjikshme se si behet ndërlidhja e kësaj marrëveshje te pretenduar nga autoriteti kontraktues dhe si mund te realizohen interesat e marrëveshjes se fshehtë kur njeri operatore ekonomik ka ofertuar ne pjesën 3 ndërsa tjetri ne pjesën 1 dhe 2.

Sipas OE Ida Auto Group, çdo tendence tjetër per te paraqitur si marrëveshje te fshehte është e pa argumentuar, pasi qe nuk ka asnjë rendësi se qfare mbiemri kane pronaret e operatorëve ekonomik deri sa askund nuk ndalohet me Ligj qe nuk lejohet te ofertohet ne një tender pronaret qe kanë mbiemër te njëjtë, madje nuk ka asnjë ndalese qoftë edhe nëse pronaret janë familjare (sepse kemi te bëjmë me biznese te ndryshme). Kurse sa i përket, çmimeve te njëjta qe janë vendos edhe ketë fakt nuk e ndalon asnjë dispozite ligjore dhe nuk mund te quhet marrëveshje e fshehtë nëse ofertohet me çmime te njëjta edhe ne nje Lot te vetëm, e lere me ne lote te ndryshme.

- OE Leicon, në përgjigje te kërkesës se OSHP-se, ka dhëne faktet dhe argumentet e veta lidhur me pretendimet e AK-se, duke propozuar qe kërkesa e AK - Policia e Kosovës, te refuzohet si e pa bazuar.

Ne sqarimin e tij, dërguar ne OSHP, OE Leicon, ka deklaruar se me rastin e ofertimit është e vërtet qe e kemi bashkangjitur sigurimin e tenderit te kompanise Ida Auto Group, por kjo ka ndodhur per shkak te nje gabimi teknik sepse edhe ne si operatore ekonomik por edhe OE Ida Auto Group ka rezultuar se e kemi nxjerr sigurimin e ofertës tek kompania Elsig dhe te njëjtit na e kanë dërguar gabimisht duke mos e na e dhëne ne emër te kompanisë tone dhe fare nuk e kemi analizuar por vetëm e kemi bashkangjitur ne ofertën tone.

OE Leicon, me tutje ka sqaruar se sigurimi i ofertës tone ka qene i shtypur nga kompania dhe i gatshëm per dorëzim, mirëpo per shkak te gabimit teknik (qe u sqarua me larte) te ndodhur është dorëzuar ne emër te kompanisë tjetër dhe njeherit e sigurimin e ofertës e ka bashkangjitur me kete sqarim te datës: 07.05.2026 dhe ketë e vërteton fakti se sigurimi ynë mban numër tjetër serik: 149292.

Sipas OE Leicon nuk mund te quhet ne asnjë mënyrë marrëveshje e fshehte fakti se nje dokument i një kompanie gjendet ne ofertën e një kompanie tjetër, e po ashtu është edhe me absurde përmendja e faktit se pronaret e kompanive kanë mbiemër te njëjtë dhe çmimet janë te njëjta.

Ne vazhdim ka deklaruar se fakti qe kemi çmime te njëjta por ne Lote te ndryshme nuk prodhon asnjë efekt dhe nuk dëshmon asgjë ne drejtim te marrëveshjeve te fshehta pasi qe janë te ndara Lotet.

Sipas OE Leicon, AK-ja, ne kërkesën e saj drejtuar OSHP-se, nuk e ka përmend fare nenin 99.2 te LPP-se, dhe ky fakt tregon qartë qe kërkesa per diskualifikim nuk ka baze ligjore dhe nuk gjen mbështetje ne nenin 99.2 te LPP-se pasi qe nuk ka përmend asnjërin nga kushtet qe duhet te plotësohen per diskualifikim.

Vlerësimi i pretendimeve te autoritetit kontraktues për marrjen e masave ndaj OE Ida Auto Group dhe OE Leicon:

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave paneli shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues – Policia e Kosovës, nuk ka dorëzuar prova që dëshmojnë se OE Ida Auto Group dhe OE Leicon, me veprimin e tyre, kanë falsifikuar apo mashtruar autoritetin kontraktues me veprimet e tyre.

Sa i përket pretendimit te autoritetit kontraktues, se OE Ida Auto Group dhe OE Leicon, kan vepruar ne kundërshtim me nenin 5 te Ligjit per Mbrojtjen e Konkurrencës, me arsyetimin se jane te ndaluara marrëveshjet qe drejtpërdrejtë ose tërthorazi caktojnë çmimet, paneli shqyrtues vlerëson se nuk qendron ky pretendim, per faktin se janë Pjesë/Lote te ndryshme te aktivitetit te prokurimit dhe fakti qe janë Lote te ndryshme nuk mund te konsiderohet marrëveshje e drejtpërdrejtë apo e tërthortë.

Paneli shqyrtues, sqaron se sipas dispozitave te nenit 18 te Rregullores per Prokurim Publik dhe nenit 4 te Udhëzuesit Operative per Prokurim Publik, autoritetit kontraktues i lejohet qe nje aktivitet te prokurimit ta ndaj ne Lote dhe fakti qe ndahet ne Pjesë/Lote konsiderohen si aktivitete te veqanta/te ndara, andaj nuk mund te konsiderohet si marrëveshje fakti qe Operatoret ekonomik, kan ofertuar ne Lote te ndryshme.

Paneli shqyrtues, lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktues se mbiemrat e dy pronareve jane te njëjtë qe sipas AK-se dëshmon se çmimi eshte i kurdisur, nuk qëndron per faktin se mbiemri i njëjtë nuk dëshmon se kan lidhje te ngushtë familjare dhe njeherit sqaroj se autoriteti kontraktues nuk ka ofruar asnjë prove lidhur me ketë pretendim.

Për marrjen e masave ndaj operatorëve ekonomik Organi Shqyrtues i Prokurimit mund vepron vetem nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 te këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, nuk ka dorëzuar prova se OE Ida Auto Group dhe OE Leicon, ka mashtruar apo falsifikuar ndonjë dëshmi.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur nenin 99.2 te LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Policia e Kosovës

1x1 OE - Ida Auto Group dhe OE Leicon

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryetar i Panelit Shqyrtues



Isa Hasani